# PLATFORMA PËR ZGJEDHJET LOKALE 2013

**Shkup - Mars, 2013**

## Të nderuar qytetarë,

Zgjedhjet lokale të vitit 2013 i shohim si një mundësi të mirë për zbatim të mirëfilltë të përvojave të suksesshme të qeverisjes me pushtetin lokal në Komunën e Gostivarit nga mandati 2009-2013 edhe në komunat tjera ku Rilindja Demokratike Kombëtare do të qeverisë komunat ose do të jetë pjesë e ekzekutivit dhe të këshillave komunale.

Problemet e shumta ndëretnike, kriza ekonomike dhe sociale në rritje, papunësia dhe varfëria e lartë, funksionimi i brishtë i shtetit juridik, politizimi dhe partizimi i skajshëm i sektorit publik dhe administratës shtetërore, korrupsioni shumë i lartë institucional, bllokimi i procesit të decentralizimit fiskal, raportet konfliktuale në mes të qeverisë qendrore dhe komunave të udhëhequra nga opozita dhe bllokimi i procesit të integrimit të vendit në strukturat euro-atlantike përbëjnë një mozaik të zymtë në plan nacional me pasoja negative në menaxhimin komunal.

Në një mozaik shumë të vështirësuar nacional dhe lokal Rilindja Demokratike Kombëtare zgjedhjet lokale të marsit të vitit 2013 i sheh si një mundësi për garë demokratike te programeve politike, ekonomike, financiare, sociale, arsimore dhe zhvillimore të ofruara dhe promovuara nga kuadro të mirëfillta me dije, përvojë, vizion dhe përkushtim për të hapur dhe siguruar një perspektivë më të mirë për qytetarët e vendit në nivel lokal.

Decentralizimi në përgjithësi dhe decentralizimi fiskal në veçanti shënojnë ngecje serioze në periudhën e deritashme dhe në Maqedoni manifestohen tendenca të qarta për bllokim të financave të komunave dhe për ndërhyrje serioze të pushtetit qendror në kompetencat burimore të komunave.

Problemi bazë i ngecjes në funksionalitetin e pushtetit komunal identifikohet me ngarkesën e lartë me borxhe të trashëguara, kriteret jo të drejta të alokimit të financave publike për komunat e niveleve të ndryshme zhvillimore, mosalokimin e

mjaftueshëm të financave publike për investime kapitale në lëmi që janë kompetenca të përbashkëta të komunave dhe qeverisë qendrore dhe moszbatimin e Ligjit për zhvillim të barabartë rajonal, që ka për pasojë thellimin e diskriminimit territorial dhe etnik, si dhe krijimin e hendekut financiar në rritje të komunave në raport me kompencat ligjore.

Në një situat të dezinvestimit të lartë në përgjithësi dhe të mungesës së mjeteve financiare në buxhetet e komunave, tërheqja e fondeve financiare nga burime të jashtme, si: IPA fondet e BE-së, donacione dhe grande nga institucione të huaja dhe kredi të buta afatgjate për investime kapitale në infrastrukturën komunale dhe arsimore, janë një mundësi shumë serioze për zbutjen e likuiditetit dhe solventitetit financiar të komunave që si praktikë, me shumë sukses është realizuar nga Komuna e Gostivarit në mandatin 2009-2013.

Refomrmat në administratën komunale, stabilizimi dhe përparimi fiskal dhe financiar i buxheteve komunale, përparimi serioz në menaxhimin me kompetencat burimore në lëmin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, menaxhimi me sukses i tokës ndërtimore, avancimi në menaxhimin me arsimin fillor dhe të mesëm, luftimi pa pardon i korrupsionit dhe evazionit fiskal, kultivimi dhe përparimi i partneritetit qytetar dhe komunal dhe partneritetit privato-publik në lëmi me interes të përbashkët dhe reformimi strukturor i ndërmarrjeve publike komunale, do të jene objektiva dhe synime madhore në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve komunale dhe rritjes së performancës së pushtetit komunal të udhëhequr nga të zgjedhurit e popullit nga radhët e Rilindjes Demokratike Kombëtare.

Rilindja Demokratike Kombëtare në këto zgjedhje lokale garon me kuadro profesionalisht të dëshmuar, me integritet të lartë moral dhe kombëtar, kuadro që kanë dije, përvojë dhe vizion për realizimin e ndryshimeve cilësore dhe reformave pozitive në të gjitha komunat e vendit në përgjithësi.

Përkushtimi tanimë i dëshmuar në menaxhimin shumë të suksesshëm katërvjeçar me komunën e Gostivarit që ka edhe verfikimin e institucioneve ndërkombëtare relevante, mbrojtja dinjitoze e interesit kombëtar shqiptar nga ana e deputetëve të RDK-së në Parlamentin e Maqedonisë dhe përcaktimet programore të RDK-së, janë garanci e plotë se Rilindja Demokratike Kombëtare ka kapacitetet e nevojshme kuadrovike dhe programore për jetësim të përcaktimeve të saja për të krijuar një të ardhme më të mirë për qytetarët e vendit.

Ne në Rilindjen Demokratike Kombëtare, votën e qytetarëve dhe në veçanti të shqiptarëve, nuk e shohim si një mundësi për tu ulur në kolltuqet qeverisëse komunale, por si një mundësi për të dëshmuar dijen, aftësitë dhe vizionin tonë për të realizuar reforma përmbajtjesore në praktikë.

Ju ftoj që përmes votës tuaj të lirë dhe demokratike të bëheni pjesë e vizionit tonë dhe pjesë e ndryshimeve pozitive për të ardhmen me të suksesshme të pushetit komunal në Maqedoni.

Së bashku të vazhdojmë me ndryshimet dhe reformat e reja drejt një të nesërme më të mirë për qytetarët e komunave tona.

Në emër të Rilindjes Demokratike Kombëtare
Prof. Dr. Rufi Osmani, kryetar

# Platforma bazë për zgjedhjet lokale 2013

## 1. Vizioni ynë

Të shndërrojmë komunat në Maqedoni në qendra të mirëfillta institucionale komunale, ekonomike, kulturore dhe arsimore që garantojnë perspektivë afatgjate për të gjithë qytetarët e vendit tonë.

## 2. Objektivat tona

Gjatë qeverisjes me komunat, kuadrot e Rilindjes Demokratike në nivel të Kryetarëve të Komunave , Kryetarëve të Këshillave Komunale dhe Këshilltarëve Komunalë do të synojnë realizimin e disa objektivave gjenerale, edhe atë:

- ✓ Reformimi i mirëfilltë i administratës publike,institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike;
- ✓ Luftë pa kompromis kundër korrupsionit, nepotizmit, mafias urbane dhe dukurive tjera negative dhe devijuese;
- ✓ Sigurim i barazisë së plotë në përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të komuniteteve tjera pakicë,
- ✓ Përdorim i plotë i simboleve kombëtare në pajtim me traditën e përdorimit dhe dispozitat juridike;
- ✓ Përfaqësim i drejtë multietnik i të gjitha bashkësive etnike,
- ✓ Krijimi i një ambienti të përshtatshëm për edukimin, arsimimin dhe përparimin e të gjitha gjeneratave dhe në veçanti të të rinjve,
- ✓ Përmirësim dhe zgjerim i kushteve hapësinore në shkollat fillore dhe të mesme komunale,
- ✓ Bashkëpunim cilësor i shkollave publike me shkollat private fillore dhe të mesme ;
- ✓ Sigurim i menaxhmentit cilësor arsimor në shkollimin fillor dhe të mesëm;
- ✓ Planifikim i mirëfilltë hapësinor dhe urbanizim i plotë;

- ✓ Krijimi i zonave ekonomike dhe industriale në nivel të komunave dhe të rajoneve në partneritet me sektorin privat;
- ✓ Përkrahje institucionale e zhvillimit të bizneseve ekzistuese dhe biznesve të reja;
- ✓ Nxitje e investimeve të brendshme dhe të huaja të drejtëpërdrejta në komuna;
- ✓ Nxitje e investimeve në prodhimtarinë bujqësore dhe blegtorale dhe zhvillimin e fshatit;
- ✓ Krijimin e qendrave komunale për zhvillim të bujqësisi dhe blegtorisë në partneritet dhe Shoqatat e fermerëve në nivel të komunave dhe të vendit;
- ✓ Krijim i vendeve të reja të punës në sekorin privat dhe publik;
- ✓ Shfrytëzim produktiv i asitencës financiare dhe teknike të institucioneve të UE dhe fondeve të tjera të huaja në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social;
- ✓ Mbrojtje e përparuar e ambientit jetësorë,
- ✓ Përmirësim cilësor dhe zgjerim i rrjetit rrugor në tërë territorin e komunave;
- ✓ Ruajtje dhe zgjerim i sipërfaqeve të gjelbra;
- ✓ Ndërtim i objekteve dhe qendrave rekreative për të rinjtë;
- ✓ Rregullim cilësor dhe zgjerim përmbajtjësor i parkingjeve;
- ✓ Krijim i institucioneve për organizim të manifestimeve kulturore, artistike dhe ruajtje të trashëgimisë historike;
- ✓ Krijim i kushteve për përparimin e sportit;
- ✓ Përmirësim i asistencës sociale dhe shërbimeve të mjekësisë primare;
- ✓ Ndërtimi i shtëpive për përkujdesje të pleqve dhe fëmijëve pa strehë;
- ✓ Ndërtimi i banesave sociale në partneritet me Ministrinë e punës dhe politikës sociale, investitorët privatë dhe shoqatat e personave të margjinalizuar në aspekt socio-

ekonomik;

- ✓ Reformim dhe transformim i tërësishëm i ndërmarrjeve publike komunale dhe dhënie me koncesion të disa shërbimeve komunale;
- ✓ Partneritet efektiv privato-publik në lëmi publike me interes për qytetarët;
- ✓ Menaxhim produktiv dhe rritje permanente e të hyrave burimore fiskale të komunave dhe eliminin i evazionit fiskal;
- ✓ Menaxhim racional dhe produktiv i të dalave publike,
- ✓ Zbatimi i tërësishëm i e-qeverisjes në punën e pushtetit komunal;
- ✓ Krijim i një sistemi qeverisës ku administrata është në tërësi në shërbim të qytetarëve të komunës;
- ✓ Krijimi i praktikës së kyçjes së plotë të qytetarëve në procesin e administrimit të komunës;
- ✓ Avansim i bashkëpunimit të administratës komunale me sektorin civil, organizatat joqeveritare dhe mediumet lokale dhe qendrore;

## 3. Parimet e qeverisjes

Gjatë qeverisjes me komunat, kuadrot e Rilindjes Demokratike si në nivel të Kryetarëve të Komunave ashtu dhe në nivel të Kryetarëve të Këshillave Komunalë dhe Këshilltarëve komunalë, do të veprojnë në përputhëshmëri me tetë parimet e qeverisjes së mirë, të dhëna nga Komisioni Ekonomik dhe Social i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, edhe atë:

1. Pjesëmarrja
   - ✓ Pjesëmarrja në vendimmarrje nga të gjitha grupet shoqërore (veçanërisht ato të pafavorizuara)
   - ✓ Pjesëmarrja mund të jetë direkte apo përmes përfaqësuesve apo institucioneve legjitime
   - ✓ Pjesëmarrje do të thotë liri në bashkëpunim dhe në shprehje dhe organizim të shoqërisë civile

2. Sundimi i ligjit
   - ✓ Qeverisja e mirë kërkon kornizë ligjore që zbatohet në mënyrë të paanshme,
   - ✓ Mbrojtje e plotë e të drejtave të njeriut
   - ✓ Gjyqësi të pavarur dhe forcë policore të paanëshme dhe të pakorruptuar

3. Transparenca
   - ✓ Marrja e vendimeve bëhet duke i respektuar rregullat
   - ✓ Informatat janë të publikuara dhe të gjithë qytetarët që janë të ndikuar nga vendimet dhe zbatimi i politikave, kanë qasje në informata dhe në vendimmarrje.

4. Partneriteti me komunitetin
   - ✓ Vendimet merren sipas nevojave dhe kërkesave të

komunitetit

5. Partneriteti me bizneset
   - ✓ Qeveria lokale përkrah bizneset në zhvillimin e tyre

6. Orientim drejt konsenzusit politik dhe harmonisë kulturore

7. Barazia dhe përfshirja

8. Efikasiteti
   - ✓ Institucionet kanë për qëllim arritjen e rezultateve sa më të larta me resurset që i kanë në dispozicion
   - ✓ Mbrojtja e resurseve natyrore dhe e ambientit

9. Përgjegjësia ndaj qytetarëve
   - ✓ Të minimizohet korrupsioni
   - ✓ Të merren parasysh kërkesat dhe nevojat e pakicave
   - ✓ Zërat e individëve dhe të grupeve të pafavorizuara të dëgjohen gjatë procesit të vendimmarjes

## 4.Stabilizim financiar dhe fiskal i komunave, parakusht për realizim të funksioneve bazë komunale

- ➢ Duke pasur parasysh faktin se financat publike në Maqedoni janë ndër më të centralizuarat në Evropë, RDK do të angazhohet për reformim të mëtejmë dhe rritje të autonomisë fiskale në nivele te ngjajshme me vendet multietnike të BE-së
- ➢ RDK do të angazhohet për ripërkufizim territorial të komunave dhe zvogëlimin e numrit të komunave në funksion të krijimit të komunave funksionale me potencial te mjaftueshëm financiar nga burimet vetjake fiskale

- RDK do të angazhohet për eliminimin e dispariteteve të mëdha fiskale ndërkomunale nëpërmjet krijimit të një sistemi të ri të ekuilibrimit të potencialit fiskal, duhet të synojë favorizimin e komunave të pazhvilluara dhe parandalimin e dispariteteve të reja
- RDK do të angazhohet për rritje të dotacionit të TVSH-së nga 3,4% në së paku 10% në dobi te buxheteve komunale, krahas rishqyrtimit të formulës së alokimit të mjeteve të TVSH-së. Duke favorizuar komunat me kapacitet fiskal të pamjaftueshëm, do të rritë performancën fiskale të komunave
- RDK do të angazhohet për rishqyrtim të kritereve për alokimin e bllok dotacioneve sipas sektorëve, duke objektivizuar kriteret e alokimit dhe duke zbatuar procedura të hapura, transparente dhe publike. Gjithnjë duke pasur për bazë funksionet dhe jo institucionet e decentralizuara, do te eliminojë diskriminimin dhe disparitetet aktuale
- RDK do të angazhohet që bllok dotacioni më i rëndësishëm i cili i dedikohet arsimit fillor, të mesëm dhe çerdheve të bazohen në kriterin e alokimit të mjeteve në bazë të numrit te nxënësve
- RDK do të angazhohet që bllok dotacionet tjera të llogariten sipas krierit për banor, ose të eliminohen si dotacione të veçanta dhe t'ju barten komunave në menaxhim në kuadër të dotacionit të përgjithshëm
- RDK do të angazhohet që të eliminohen dispozita ligjore me të cilat pushteti qendror bën kufizimin e së drejtës së huazimit të komunave për realizimin e investimeve kapitale dhe në këto suaza Ministria e financave të ketë vetëm rolin kontrollues, përkundër rolit vendimmarrës që e ka me ligjet aktuale në fuqi

## 6.Zhvillimi ekonomik lokal

Gjatë qeverisjes me komunat, kuadrot e Rilindjes Demokratike Kombëtare si në nivel të Kryetarëve të Komunave ashtu dhe në nivel të Kryetarëve të Këshillave Komunalë dhe Këshilltarëve Komunalë, do të veprojnë në drejtimet vijuese në fushën e zhvillimit ekonomik lokal:

- ✓ Rëndësi e madhe do t'i kushtohet përkrahjes së zhvillimit të kapaciteteve ekzistuese ekonomike dhe krijimit të kushteve përkatëse për krijim të kapaciteteve të reja ekonomike
- ✓ Qasja e deritashme "Bizneset duhet të vijnë atje ku është infrastruktura", do të zëvendësohet me konceptin: "Infrastruktura duhet të shkojë te bizneset"
- ✓ Qeverisja e re komunale do të ketë qëndrim proaktiv ndaj bizneseve të reja në kuptim të përkrahjes teknike në procesin e themelimit dhe zhvillimit të bizneseve në bashkëpunim partneriteti me ministritë përkatëse në funksion të jetësimit praktik të sistemit me një sportel
- ✓ Do të përkrahim iniciativat për bashkëpunim rajonal ekonomik në kuadër të rajonit të Pollogut si rajon me përparësi komparative dhe resurse komplementare në funksion të tërheqjes së investimeve më voluminoze të huaja
- ✓ Një rëndësi primare do ti kushtohet shfrytëzimit të fondeve ndërkombëtare me të cilat mundet në masë të madhe të tejkalohen problemet e shumta me të cilat ballafaqohen komunat tona
- ✓ Do të përpilojmë strategji komunale kompatibile me strategjinë nacionale për punësim
- ✓ Do të përkrahen projektet për asistencë teknike dhe financiare që mundësojnë vetëpunësimin, punësimin në

bizneset e vogla dhe punësimin në bazë të programeve sociale të personave të papunësuar.

- Do të miratojmë rregullore për zvogëlim deri në heqje komplete të taksës komunale dhe tatimit në pronë në periudhë deri në pesë vite, për investimet e reja prodhuese që hapin mbi 10 vende të reja pune
- Me planet urbanistike, do të parashohim krijimin e zonave industriale dhe parqeve teknologjike të cilat do t'i rregullojmë në plan infrastrukturor në funksion të tërheqjes së investitorëve të huaj dhe vendorë
- Do të iniciojmë themelimin e Departamentit për stimulim të investimeve të brendshme dhe të huaja në komunat shqiptare në Maqedoni
- Do të iniciojmë dhe përkrahim, në bashkëpunim me Universitetet në vend, themelimin e biznes-inkubatorëve për sektorët me përparësi komparative
- Do të iniciojmë themelimin e Qendrave komunale për rikualifikimin e punëtorëve të shpallur tepricë teknologjike dhe ekonomike, sipas kërkesave të tregut të punës
- Do të themelojmë Grupin Aksional Lokal të përberë nga të gjitha palët e interesuara për zhvillimin e bujqësisë dhe ambientit rural (pushteti komunal, subjektet ekonomike bujqësore, organizatat joqeveritare bujqësore dhe shoqatat e bujqve),
- Do të financojmë përpilimin e strategjisë afatmesme dhe afatgjate për zhvillim të bujqësisë dhe ambientit rural
- Do të krijojmë Zyra për informim, përkrahje të bujqësisë, përkrahje të ambientit rural dhe bashkëpunimit me donatorë të huaj
- Do të ofrojmë asistencë teknike dhe financiare në funksion të krijimit dhe zhvillimit të shoqatave të bujqve, me qëllim të plotësimit të nevojave të anëtarëve të tyre në funksion të përparimit të veprimtarisë bujqësore

- ✓ Sektori për zhvillim ekonomik lokal, do të ketë përgjegjësi të organizojë takime permanente me përfaqësuesit e bizneseve private, me qëllim të shqyrtimit jo vetëm të çështjeve që kanë të bëjnë me nevojat e sektorit publik, por edhe të gjetjes së mënyrave dhe alternativave që sektori publik të kontrubojë për zhvillimin e sektorit privat
- ✓ Një rëndësi të madhe do t'i kushtojmë parimit të komunikimit transparent të komunës me sektorin privat, e që do të rezultojë me eliminimin e të gjitha mundësive për favorizime dhe në këtë mënyrë do të krijohen kushte optimale për zhvillim dhe avancim të partneritetit privato-publik.
- ✓ Do të përgatisim strategji të veçantë për fushat që janë kompatibile për bashkëpunim me donatorët e jashtëm në funksion të zhvillimit ekonomik dhe realizimit të investimeve kapitale në të gjitha sferat që janë kompetencë e menaxhimit të komunave
- ✓ Në kuadër të qendrave të renomuara rajonale dhe evropiane, do të dërgojmë për avancim një pjesë të stafit komunal që të mundet në mënyrë meritore të plotësojë kriteret dhe standardet për bashkëpunim ndërkombëtar.

## 7. Zhvillimi rural

- ✓ Rëndësi e veçantë në qeverisjen e ardhshme komunale do t'i kushtohet zhvillimit rural
- ✓ Në bashkëpunim me Shoqatën e Fermerëve të Maqedonisë do të instalojmë Qendra për trajnimin e bujqeve dhe blegetorëve në funkcion të përpilimit dhe aplikimit të projekteve për shfrytëzim të fondeve nga IPARD Programi dhe nga programet qeveritare dhe të huaja
- ✓ Përkrahja e komunës do të nënkuptojë zhvillimin e infrastrukturës rurale si rrugë, kanalizime, ujësjellës, ndriçim publik etj. Projektet e tilla do të rrisin kualitetin e jetës së

qytetarëve në këto lokalitete, si dhe do të mundësojnë një zhvillim të hovshëm ekonomik të këtyre zonave

- ✓ Kujdes i veçantë do t'i kushtohet shfrytëzimit efiçient të tokës bujqësore dhe veçanërisht asaj blegtorale, e cila në Komunën e Gostivarit është një resurs shumë i çmuar
- ✓ Do të punohet me përkushtim në ridefinimin e organizimit territorial të komunës në kontekst të definimit të zonave të banuara, tokave bujqësore, tokave blegtorale, zonave ekonomike, zonave të mbrojtura, ujërave, zonave historike dhe kulturore etj.
- ✓ Do të mbështetet aplikimi i prodhimtarisë ekologjike si dhe aplikimi i teknikave bashkëkohore në prodhimin bujqësor dhe blegtoral. Do të mbështeten në veçanti projektet që kanë të bëjnë me grumbullimin e qumështit dhe produkteve tjera blegtorale, ngase kjo gjeneron punësim dhe të ardhura në gjithë zinxhirin e prodhimit duke filluar nga ferma, prodhuesit e ushqimit të kafshëve, bizneset përpunuese, transportuese etj.
- ✓ Në fushën e blegtorisë, do të mbështeten bujqit që adaptojnë racë më kualitative dhe produktive të gjedheve dhe kafshëve të tjera
- ✓ Do të investohet në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe në mirëmbajtjen dhe ruajtjen e lumenjve nga keqpërdorimi dhe shfrytëzimi joefikas

Prioritet dhe kërkesa më të veçuara në fushën e zhvillimit rural:

- ✓ Stimulimi i bujqve me grande dhe ndihma tjera në sferat e ndryshme të bujqësisë (në veçanti fshatrat kodrinore), ngritja e serave
- ✓ Ndërtimi i mini-fermave blegtorale, sidomos në fshatrat kodrinore-malore
- ✓ Ndertimi i rrugëve të reja malore dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore

## 8. Arsimi, kultura, sporti dhe bashkëpunimi me sektorin civil

Gjatë qeverisjes me komunat, kuadrot e Rilindjes Demokratike si në nivel të Kryetarëve të Komunave, në nivel të Kryetarëve të Këshillave Komunalë dhe Këshilltarëve Komunalë do të veprojnë në drejtimet vijuese:

- ✓ Do të iniciojnë përfundimin e ndërtimit të godinave shkollore që janë në fazë të ndërtimit dhe renovimit dhe ndërtimin e sallave sportive në shkollat publike,
- ✓ Do të inicojnë procesin e rinovimit të objekteve shkollore duke u dhënë prioritet shkollave në ambientet rurale të cilat janë më shumë të amortizuara
- ✓ Do të synohet pajisja e shkollave qendrore me laboratore përkatëse në drejtim të ngritjes së shkallës së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies
- ✓ Do të mirëmbahen, në përputhëshmëri me standardet bashkëkohore, ambientet përreth shkollave si një pasqyrë e cilësisë së menaxhimit me to
- ✓ Do të synohet gjetja e mundësive për hapje të menzave funksionale për nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme komunale
- ✓ Do të synohet mirëmbajtja dhe renovimi i sallave sportive të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe ndërtimi i sallave të reja sportive në shkollat ku ato mungojnë
- ✓ Përmjet implementimit të praktikave të mira të përfituara gjatë qeverisjes me komunën e Gostivarit edhe në komunat tjera në vend, në aspektin cilësor do të zgjidhet problemi i ngrohjes së shkollave fillore dhe të mesme duke garantuar kësisoji kushte më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie
- ✓ Në kontinuitet do të luftohet për sigurim të mjeteve financiare nga institucionet relevante ndërkombëtare për ripajisje dhe rindërtim të laboratoreve në shkollat e mesme
- ✓ Në kontinuitet do të luftohet për sigurim të mjeteve financiare nga institucionet relevante ndërkombëtare, për

zëvendësim të inventarit të vjetruar dhe plotësisht të amortizuar në shkollat fillore dhe të mesme komunale

- ✓ Në bashkëpunim me institucionet përkatëse ndërkombëtare dhe vendore, do të sigurohen kurse falas nga informatika dhe gjuhët e huaja për nxënësit e shkollave fillore komunale
- ✓ Do të angazhohemi që në bashkëpunim me Universitet në vend, institucionet relevante ndërkombëtare dhe fondacionet vendore, të sigurojmë përkrahje teknike dhe financiare për të rinjtë e talentuar që nuk kanë mundësi për të mbuluar shpenzimet e studimeve
- ✓ Do të angazhohemi që në bashkëpunim me institucionet relevante ndërkombëtare dhe fondacionet vendore, të themelojmë fondacionine për financim të nxënësve dhe studentëve të talentuar
- ✓ Do të ndërmjetësojmë me kompanitë publike dhe private me qëllim të krijimit të kushteve që studentët që janë në përfundim të studimeve të kryejnë punë praktike në institucionet komunale dhe kompani private, me qëllim që pas diplomimit të kenë mundësi më lehtë të kyçen në tregun e punës dhe tu përgjigjen sfidave në vendin e punës
- ✓ Personave të interesuar do tu ofrojmë përkrahje teknike, administrative dhe akademike me qëllim të konkurrimit cilësor pranë fondacioneve të huaja
- ✓ Të gjithë personave që janë duke i vijuar studimet pasuniversitare, do tu garantojmë qasje falas ndaj bazave elektronike të revistave ndërkombëtare dhe librave shkencorë bashkëkohorë, nëpërmjet sigurimit të qasjes në rrjetet e tilla si EBSCO dhe British Council
- ✓ Nëpërmjet BNJLV do të iniciojmë procedurë për rritjen e pjesëmarrjes së financimit të arsimit fillor dhe të mesëm në përqindje, së paku tre herë më të lartë në krahasim me financimin ekzistues

- ✓ Do të iniciojmë propozim për formulimin preciz të metodologjisë së ndarjes dhe distribuimit të mjeteve si bllok dotacione dhe investime kapitale
- ✓ Do të iniciojmë propozim për ndryshime cilësore në përmbajtjen e plan-programeve mësimore dhe mënyrës së realizimit të mësimdhënies dhe raporteve nxënës-profesor, në kuptim të demokratizimit të mëtejmë të këtij procesi duke ngritur përgjegjësinë e të gjitha palëve të përfshira në arsim
- ✓ Do të ofrojmë alternativa për themelimin e shkollave fillore dhe të mesme private me programe bashkëkohore që janë kompatibile me arsimin publik ekzistues
- ✓ Do të ofrojmë siguri shtesë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme
- ✓ Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe fondacionet e jashtme, do të themelojmë festivalin për avancimin e shtatë arteve në kuadër të javës kulturore e cila do të organizohet në më shumë komuna në vend
- ✓ Do të organizojmë ekspozimin e punimeve artistike të artistëve të dalluar dhe të nxënësve të shkollave komunale
- ✓ Pushteti lokal do të merr pjesë aktive në organizimin dhe pasurimin e jetës sportive-rekreative të komunave
- ✓ Pushteti komunal do të krijojë kushte për kyçjen aktive të të rinjve dhe shoqatave të qytetarëve në jetën rekreative-sportive
- ✓ Do të hulumtohen investitorë të brendshëm dhe të jashtëm për ndërtimin e komplekseve rekreativo-sportive;
- ✓ Pushteti komunal do të financojë në mënyrë aktive sportin në komuna
- ✓ Në suaza të mundësive buxhetore do të përkrahen në aspekt teknik dhe financiar organizatat joqeveritare si korrektor dhe nxitës të zhvillimeve demokratike dhe ngritjes së vetëdijes civile të qytetarëve

**9. Mbrojtja sociale dhe shëndetësia primare**

Gjatë qeverisjes me komunat, kuadrot e Rilindjes Demokratike në nivel të Kryetarëve të Komunave, Kryetarëve të Këshillave Komunalë dhe Këshilltarëve Komunalë do të veprojnë në drejtimet vijuese në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësisë primare:

- ✓ Do të iniciojmë përshpejtimin e procedurës për kalim të menaxhimit të mjekësisë primare në kompetencë të komunave;
- ✓ Do të ofrojmë përkrahje teknike, administrative dhe financiare për trajtim ditor të personave me varëshmëri nga mjetet narkotike
- ✓ Në bashkëpunim me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme komunale si dhe sektorin joqeveritarë do të organizohen ligjërata dhe trajnime permanente për vetëdijësimin e nxënësve rreth pasojave negative që shkaktojnë duhani,alkooli dhe mjetet narkotike
- ✓ Do të tregohet një kujdes i veçantë dhe do të ofrohet përkrahje për fëmijët në rrugë përmjet projekteve të bashkëmenaxhuara nga ana e komunave, sektorit joqeveritar dhe institucioneve relevante ndërkombëtare
- ✓ Do të iniciojmë, koordinojmë dhe financiarisht do të përkrahim projekte për rritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe aftësimin e tyre për të identifikuar dhe paraqitur rastet e dhunës familjare
- ✓ Do të zgjerojmë rrjetin e Kopshteve për fëmijë në qytet dhe në mjediset rurale
- ✓ Do të ofrojmë tërë përkrahjen teknike, administrative dhe logjistike për krijimin e kushte optimale për ndërtim të banesave sociale në komunat shqiptare
- ✓ Do të ofrojmë përkrahejn e nevojshme administrative dhe logjistike për hapjen e Qendrave rajonale për përkujdesje

të personave të moshuar, personave të hendikepuar dhe invalidët

- ✓ Në bashkëpunim me botën e biznesit dhe sektorin joqeveritar, do të iniciojmë hapjen e "kuzhinave popullore" në një pjesë të mjediseve ku një nevojë e tillë është mëse evidente
- ✓ Do të ofrojmë asistencë administrative dhe financiare shoqatave të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve;
- ✓ Do të bashkëpunojmë me institucionet qendrore medicinale në eliminimin e individëve dhe organizatave që ofrojnë shërbime medicinale joformale

## 10. Reformimi funksional dhe organizativ i administratave komunale

Të vetëdijëshëm për rolin dhe rëndësinë e administratës komunale në procesin e menaxhimit të pushtetit lokal, kuadrot e Rilindjes Demokratike Kombëtare me synim të sigurimit të një funksionimi më efikas të administratave komunale, do të angazhohen në drejtimet vijuese:

- ✓ Rritje e kompetencave funksionale të Këshillit të Komunës dhe kthimit të kompetencave bashkësive lokale
- ✓ Përforcim i shërbimeve të revizionit dhe të kontrollit në funksion të luftimit preventiv të dukurive negative në funksionimin e admnistratës komunale
- ✓ Evitim i të gjitha mundësive për keqpërdorim të pozitave zyrtare nga ana e bartësve të pushtetit në nivel komunal
- ✓ Rritje e efikasitetit në procesin e procesuimit të kërkesave të qytetarëve
- ✓ Ulje e gjasave për bërje të manipulimeve, marrje të mitës dhe korrupsion nga administrata komunale
- ✓ Ulje e shpenzimeve administrative komunale

- ✓ Rritje e transparencës në procesin e funksionimit të admistratës komunale

## 11. Planifikimi hapësinor dhe urbanistik

Analizat e kryera nga profesionistë të kësaj lëmie, nxjerrin në sipërfaqe devijime të shumta në funksionimin e departamenteve për urbanizëm dhe planifikim hapësinor në shumë komuna të vendit. Informaliteti në procedura, i ndjekur me lejimin e heshtur të ndërtimeve të egra, mbetet një “kancer” për një pjesë të madhe të komunave në përgjithësi dhe komunave urbane në veçanti.

Me qëllim të tejkalimit të situatave aktuale, çmojmë se duhet ndërmarrur një varg aktivitete permanente, si: Komuna, respektivisht Sektori me Departamentin e urbanizmit dhe mbrojtjen e ambientit, komunikacion dhe veprimtari komunale, duhet të respektojë detyrimisht dispozitat ligjore për Planifikim hapësinor dhe urbanistik të RM-së.

- ✓ Të realizohet mbikëqyrja e pandërprerë administrative dhe inspektuese
- ✓ Të iniciohen iniciativa dhe procedura permanente pranë Ministrisë së Transportit dhe Lidhje për korrigjim, ndryshim dhe miratim të Planeve detale urbanistike me synim liberalizimin e ndërtimit në dobi të qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik lokal
- ✓ Të krijohet Departament i veçantë në funksion të realizimit me sukses të menaxhimit të tokës ndërtimore dhe ndryshimeve permanente të Planeve detale urbanistike në funksion të menaxhimit sa më efektiv dhe më efikas të tokës ndërtimore, bazuar në parimet e konkurrimit korrekt dhe transparencës së plotë

- ✓ Nga mjetet e rregullta buxhetore, duhet të financohet puna e një grupi ekspertësh që do të japë ide dhe do të përpilojë plane zhvillimore urbanistike
- ✓ Në kuadër të planeve urbanistike, do të planifikohet krijimi i zonave industriale, zonave ekonomike, zonave rekreativo-sportive etj.

## 12. Ndërmarrjet komunale dhe menaxhmenti i ri publik

Të gjitha analizat e mirëfillta dhe konsultat me eksperts dhe qytetar, bëjnë të qartë që në shumicën e rasteve këto ndërmarrje vuajnë nga keqmenaxhimi ndër vite dhe nga problmet e shumta të trashëguara në aspekt të borxheve të larta, organizimit të dobët, mungesës së fondeve financiare dhe kuadrove të mirëfillta.

Synim parësor i Rilindjes Demokratike Kombëtare, në këtë drejtim, do të jetë reformimi i mënyrës së menaxhimit dhe funksionimit të ndërmarjeve publike nëpër komuna me qëllim që të njëjtat të vendosen në shërbim të plotë të qytetarëve.

Ndërmarrjet publike do të trajtohen si aktive me rëndësi të komunave përmes të cilave do të synohet zgjedhja e problemeve kyçe me të cilat ballafaqohen qytetarët tonë, duke filluar nga problemet me furnizimin me ujë të pijshëm, përmes deponive të shumta të egra e deri te rrjetet e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe menaxhimi me mbeturinat dhe hedhurinat.

Partneriteti privato-publik dhe dhënia me koncesion e disa nga veprimtaritë bazë të ndërmarrjeve publike, do të jetë një nga mënyrat e reformimit strukturor të këtyre subjekteve në fuksion të transformimit nga humbës të mëdhenj, në kompani me shërbime cilësore dhe me qëndrueshmëri financiare.

## 13. IPA fondet – Fondet para-aderuese Evropiane për Maqedoni

IPA janë krijuar me Regulloren e këshillit (EC) 1085/2006 më 17 Qershor 2006 dhe implementohen me Regulloren e komisionit (EC) 718/2007.

Me anë të instrumentit IPA, vendosen nën një obmrellë fondet e BE të mëparshme për shtetet kandidatë për BE, siç janë PHARE, ISPA, SAPARD, CARDS.

Ky lloj instrumenti pasqyron fondet europiane strukturore dhe i ndihmon shtetet që janë në rrugë për anëtarësim për BE, të mësojnë menaxhimin me to. IPA ka disa komponenta, edhe atë:

1. Asistenca e tranzicionit dhe ngritja e institucioneve
2. Bashkëpunimi ndërkufitar (me shtetet e BE dhe me vendet tjera të përshtatshme për IPA)
3. Zhvillimi regjional (duke mundësuar asistencë për transportin, infrastrukturën mjedisore si dhe nxitja e konkurrencës dhe reduktimi i pabarazive rajonale)
4. Zhvillimi i resurseve njerëzore
5. Zhvillimi rural – IPARD

Komponenta 1 dhe 2 janë të hapura për të gjithë shtetet kandidate potenciale, ndërsa të gjitha komponentat janë vetëm për shtetet kandidate (Kroacia, Turqia dhe Maqedonia). Për Maqedoninë, buxheti i përgjithshëm për kornizën kohore 2007-2013 është 622,5 milion EURO - e ndarë nëpër komponenta, ku pjea më e madhe e mjeteve janë për komopnentën 1, ndërsa më pak për komponentin 2 dhe 5.

Maqedonia mori akreditimin për menaxhim të decentraliziar me IPA fondet për komponentën 3 dhe 4 më shtator 2009. Akreditimi për komponentat 1 dhe 2 në vjeshtën e vitit 2010, ndërsa komponenti 5 menaxhohet nga Agjencia pagesore.

**Ku janë pushtetet lokale në mozaikun e IPA fondeve?**

Njesitë e pushteteve lokale janë përfitues të drejtë dhe indirekt të IPA fondeve, që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve lokalë.

Si aplikues, komuna në partneritet me palë tjera, mund të paraqitet vetëm në komponentën numër 2 - bashkëpunimi ndëkufitar, ndërsa në komponentat tjera komunat nuk janë përfitues të drejtëpërdrejtë, por janë projekte që implenentohen nga niveli qendror, shoqatat joqeveritare, asociacionet e biznesit si dhe komponenta 5 - personat juridikë në sferën e zhvillimit rural.

Përfitues të drejtëpërdrejtë si aplikues, komunat mund të paraqiten në komponentën 2 të bashkëpunimit ndërkufitar, me zonën ku është e vendosur. Për Maqedoninë perëndimore, ku gravitojnë shumica e komunave shqiptare kanë qenë të kapshme fondet për bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë dhe në perspektivë me Republikën e Kosovës.

Aktualisht, deri tash, me Republikën e Shqipërisë kanë kaluar 3 thirrje për projekte, ku komunat kanë pasur mundësi të aplikojnë me projekte për masat e parapara, edhe atë:

- Zhvillimi ekonomik me theks të veçantë të turizmit në këto hapësira
- Zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor me theks mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe eko-sistemet
- Kohezioni social

Buxheti për vitet 2007-2009 nga të cilat janë realizuar shpalljet, është gjithsej 4,2 milion EURO nga buxheti i BE, si dhe 744,000 Euro participim i buxhetit nacional të Maqedonisë. Gjithsej fonde të mundshme rreth 5 miolion euro për aplikuesin në RM.

Kuadrot e RDK-së në pushtetin komunal, do të angazhohen për eliminimin e pengesave për mosmiratimin e projekteve në IPA 2, si më poshtë :

- Mospasja e Strategjive zhvillimore lokale dhe nacionale të bazuara në resurset dhe mundësitë reale
- Mungesa e kapaciteteve administrative lokale
- Mungesa e resurseve njerëzore në sektorin civil dhe atë privat
- Sektori joqeveritar i dobët si dhe mungesa e linqeve "pushtet lokal – sektor joqeveritar"
- Mungesa e projekteve të përpiluara
- Dokumentacioni si dhe procedurat administrative gjatë aplikimeve

Në funksion të tejkalimit të vështirësive të mësipërme, do të ndërmerren aktivitetet vijuese institicionale:

- Zhvillimi i linqeve "pushtet vendor - OJQ - sektor publik"
- Hartimi i strategjive reale zhvillimore
- Përpilimi i projekteve paraprake
- Ngritja e resurseve humane me anë të edukimit joformal për përpilimin dhe realizimin e projekte zhvillimore

**Kandidatët për kryetarë të komunave**
**dhe për këshilltarë komunalw:**

**Komuna e Gostivarit :**
**Prof. Dr. Rufi Osmani -** Kandidat për Kryetar Komune
**Afrim Iljazi** - Bartës i listës për Këshillin e Komunës,

**Komuna e Tetoves :**
**Prof.Dr.Izet Zeqiri** - Kandidat për Kryetar Komune
**Hamdi Saiti** - Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Qyteti i Shkupit:**
**Lulzim Farizi -** Kandidat për Kryetar Komune
**Vebi Qerimi -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Çairit:**
**Gykten Haziri -** Kandidat për Kryetar Komune
**Adnan Sejfullaji -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Kumanovës:**
**Fatri Saliu -** Kandidat për Kryetar Komune
**Zenun Ismaili** - Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Tearcës:**
**Ramadan Idrizi -** Kandidat për Kryetar Komune
**Bashkim Veliu -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Zhelinës:**
**Beqir Çerkezi -** Kandidat për Kryetar Komune

**Nderim Alii** - Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Bogovinës:**
**Agim Rrahmani -** Kandidat për Kryetar Komune
**Abdulla Azizi -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Vrapçishtit :**
**Jusuf Hasani (RDK- PDT) -** Kandidat për Kryetar Komune
**Irihan Ebibi (RDK) -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Likovës:**
**Elhami Ademi -** Kandidat për Kryetar Komune
**Gazmend Saiti -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Haraçinës:**
**Fekri Bilalli -** Kandidat për Kryetar Komune
**Liridona Nuhi -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Studeniçanit:**
**Meshahir Ismaili -** Kandidat për Kryetar Komune
**Sabahudin Imeri -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Sarajit:**
**Blerim Halimi -** Kandidat për Kryetar Komune
**Avni Bajramovski -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Dollnenit:**
**Ibraimali Asanoski -** Kandidat për Kryetar Komune
**Nevzat Jakupi -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Strugës:**
**Ardian Demiri -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Kërçovës:**
**Shefki Jashari -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna Ohër:**
**Agron Reçi -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Bërvenicës:**
**Zejni Mazllami -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Jegunovcës:**
**Besir Abazi -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Butelit:**
**Naser Curri -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Gazibabës:**
**Abdilkerim Ibishi -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Sopishtës:**
**Amet Ametovski -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Zelinikovës:**
**Xhezmi Demir -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Krushevës:**
**Adnan Sulejmani -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës

**Komuna e Çashkës:**
**Meqail Zeqirov -** Bartës i listës për Këshillin e Komunës